



UNIVERSITETI I TETOVËS
УНИВЕРЗИТЕТ ВО ТЕТОВО - UNIVERSITY OF TETOVA

Bul. "linden" p.n. 1200 Tetovë | Tel: +389 44 356 500 | Fax: +389 44 356 222
e-mail: international@unite.edu.mk | www.unite.edu.mk

NJOFTIM

Njoftohen të interesuarit se **Buletini nr. 132** i Universitetit të Tetovës është publik dhe i njëjti mund të shikohet nga të interesuarit te Dekanët e fakulteteve të Universitetit të Tetovës.

Buletini do të jetë publik duke filluar nga 28.08.2018 deri më 11.09.2018.

Tetovë, më 28.08.2018



UNIVERSITETI I TETOVËS
FAKULTETIT FILOLOGJIK

Në bazë të neneve 125 dhe 131 të Ligjit për arsimin e lartë (Gaz. Zyrtare e RM-së nr. 35/2008, 103/2008, 26/2009, 83/2009, 99/2009, 115/10, 17/11, 51/11, 123/12, 15/13, 24/13, 41/14, 116/14, 130/14, 10/15, 20/15, 98/15, 145/15, 154/15, 30/16, 120/16 dhe 127/16), Rregullores për kriteret dhe procedurën për zgjedhje në thirrje mësimore-shkencore, shkencore, mësimore-profesionale dhe të bashkëpunëtorëve në Universitetin e Tetovës si dhe në mbështetje të nenit 144 të Statutit të Universitetit të Tetovës, në 5 maj 2018, në gazeta dhe portale zyrtare, Shpallet Konkurs për zgjedhjen-rizgjedhjen e mësimdhënësve në të gjitha thirrjet mësimore-shkencore në Universitetin e Tetovës: (ku në mesin e fakulteteve edhe për) FAKULTETI FILOLOGJIK, ku (kërkohet) një mësimdhënës për lëndët: -

1. Historia e librit dhe
2. Civilizimi shqiptar.

Bazuar në këtë konkurs Këshilli –Mësimor Shkencor i Fakultetit Filologjik, Universiteti i Tetovës, në mbledhjen e mbajtur më 30 maj 2018 dhe vendim të Këshillit të Rektoratit nr. _____, të datës _____, solli Propozim-Vendimin për formimin e Komisionit Recensues për zgjedhje-rizgjedhje të mësimdhënësit për lëndët:, në përbërje:

1. Prof. dr. Ejup Hajdini – profesor i rregullt (kryetar);
2. Prof.dr. Lultjeta Isakur, profesoreshë e rregullt (anëtare)
3. Prof. dr. Salajdin Saliu – profesor doc. Por në procedurë administrative e ka fituar thirrjen shkencore inordinar (anëtar).

Pas marrjes së konfirmimit se jemi anëtar të Komisioni Recensues, të zgjedhur prej Këshillit Mësimor – Shkencor të Fakultetit Filologjik të Universitetit të Tetovës për të shqyrtuar dhe për të vlerësuar krijimtarinë shkencore, profesionale dhe veprimtarinë shkencore të kandidatit Doc. dr. **Nazmi Beqiri, paraqesim:**

REFERAT

PËR ZGJEDHJEN E NJË MËSIMDHËNËSI NË THIRRJEN MËSIMORE-SHKENCORE PROFESOR DOCENT NË FAKULTETIN FILOLOGJIK NË UNIVERSITETIN SHTETËROR TË TETOVËS

Me datë 5 maj 2018 në gazetat “Koha” dhe „Nova Makedonija”, si dhe në faqen zyrtare (të internetit) të UT-së www.unite.edu.mk, është shpallur konkurs për zgjedhje-rizgjedhje të një mësimdhënësi në Fakultetin Filologjik për lëndët:

1. Historia e librit dhe
2. Civilizimi shqiptar.

Komisioni në fjalë, pasi kontrolloi materialet e dorëzuara, konstatoi se në konkurs si kandidat i vetëm është paraqitur dr. as. Nazmi Beqiri, i punësuar në marrëdhënie të rregullt pune, si **asistent** në Fakultetin Filologjik të Universitetit të Tetovës.

I. TË DHËNAT BIOGRAFIKE DHE ZHVILLIMI PROFESIONAL

A. Të dhënat themelore

Dr. Nazmi Beqiri ka lindur me 6 gusht 1960 në fshatin Izvor (Kron). Shkollimin fillor e kreu në fshatin e lindjes (nga 1-4 vjet) dhe në fshatin Sllupčan (nga 5-8). Shkollimin e mesëm e kreu në Sh.M. „Mosha Pjade” në Kumanovë. Fakultetin e kreu në Universitetin e Prishtinës në drejtimin Gjuhë dhe letërsi shqipe, në fushën e folklorit, nën drejtimin e Prof.dr. Enver Memetit (mentor), me temën: “Këngët e kaçakëve në Malësinë e Karadakut”.

Në vitin akademik 2005/2006, regjistrohet në Universitetin e Tiranës, në drejtimin Letërsi shqiptare dhe arrin të mbrojë Magjistraturën me 2008, nën drejtimin e Prof.dr. Josif Papagjonit (mentor) në temën “Drama shqipe në Maqedoni nga fillet e saja deri më sot”. E mbron me sukses pran komisionit: Prof.dr. Stefan Çapaliku (kryetar), Prof.dr. Adriatik Kallulli (anëtarë), Prof.dr. Sadik Bejko (anëtar), Prof.dr. Ymer Çiraku (anëtar) dhe Prof.dr. Josif Papagjoni (mentor). Me insistim të Prof.dr. Adriatik Kallullit dhe Prof. Dr Josif Papagjonit, e boton këtë temë të cilën ia promovojnë dy profesorët e përmendur.

Më 2011 arrin të regjistrojë doktoratën në Universitetin e “Shën Cirili dhe Metodi”, në Fakultetin Filologjik “Blazhe Koneski”, ku arrit ta mbrojë temën e disertacionit “Modelimi i personaliteteve (me shembuj nga letërsia popullore shqiptare)”, në përbërje: d-r Hamit Xhaferi, profesor i rregullt (mentor), d-r Zeqirija Neziri, profesor i rregullt, d-r Marko Kitevski, profesor i rregullt, d-r Avzi Mustafa, profesor i rregullt dhe d-r Asllan Hamiti, profesor i rregullt, me datë 28 prill 2016. Vlen të theksohet se, të dy temat e tij të diplomave janë të fushave ku studiohet për herë të parë, kurse tema e doktoratës është e vetmja (risi shkencore) në fushën e folkloristikës.

B. Marrja e thirrjeve mësimore

Dr.ass. Nazmi Beqiri, që nga 2008 punon si bashkëpunëtor dhe dr. asistent . në F. Filologjikë. Kjo është hera e parë që po shqyrtohet kërkesa e tij për thirrje mësimore-shkencore.

II. VEPRIMTARIA MËSIMORE-ARSIMORE

Më 2008 angazhohet në USHT, ku ligjeron lëndën, Gjuhë shqipe në F.A. Biznesit, Kumanovë, F.A. Publike, Kumanovë, në FSHMN, F. Fizikë, Tetovë, F. Matematikë, Tetovë, F. Informatikës Kumanovë dhe Tetovë, Biologji, dhe Biokimi, Tetovë, në F.F. ESR, Tetovë. Në F.J, Gazetari dhe medime, Gjuhë shqipe II, Gjuhë shqipe III, Gjuhë shqipe IV, Tetovë dhe Shkup. Në F. Arteve, Programit Studimor Pikturë dhe Dizajnë, Civilizim dhe kulturë shqiptare, Programit Studimor. Dramë, lëndën Historia e dramës shqipe dhe botërore. Po të njëjtën lëndë e ligjeron edhe pran Programit Studimor, Regji, Tetovë. Në F. Ekonomik, Civilizim dhe kulturë shqiptare, Shkup. Në Fakultetin Filologjik, ligjëroi lëndët, Gjuhë shqipe, Tetovë dhe Kumanovë, Teoria e letërsisë, Kumanovë, Historia e Librit, Tetovë , të cilat lëndë i ligjeron deri më sot 2017/2018. Mbulues të lëndëve ka pasur: Prof.dr. Izmit Dërmishi, Prof.dr Salajdin Saliu, Prof.dr Berton Sulejmani, Prof.dr Arlind Farizi.

III. VEPRIMTARIA SHKENCORE-HULUMTUESE

Me krijimtari letrare (veç cekëm) se merrej prej shkollës së mesme dhe gjatë viteve tetëdhjeta, kurse botimet e para do t'i bëj (do t'ia botojnë) vetëm pas ndryshimit të sistemit në revistat e pavarura, si: Doruntina, Kushtrimi, Vlera, E vërteta, Flaka e vëllazërimit, Fakti, Studime Albanologjike e tj. Ai është recensent dhe redaktor i disa librave.

Është organizator, udhëheqës dhe pjesëmarrës në simpoziume, tribuna dhe konferenca shkencore.

Ka marrë disa mirënjohje dhe dekorata ndër të cilat edhe nga Presidenti i Republikës së Kosovës.

Organizator i simpoziumeve, tribunave dhe konferencave:

Simpozium, i organizuar dhe i mbështetur nga Qeveria e RM-së dhe Komunës së Kumanovës, me temë “Kumanova për paqe 2008”, Kumtesa, “Shqiptarët e Kumanovës Brenda realitetit ndëretnik”.

Tribunë: Qëndresa e pashkëputshme ndër shekuj 2010, Sllupçan, etj.

Organizator, dhe moderator i Manifestim i 30 vjetorit të demonstratave të vitit 1981 me titull “Bashkojmë gjeneratat që sfiduan makineritë shtypëse deri në këtë jubilar të 11 marsit”, (forum mbarëshqiptarë, me pjesëmarrës që kanë prezantuar në mbledhjen e Bunjajt e deri te një trashëgimtar i vetëm i një dëshmori. Vlen të përmenden pjesëmarrësit: Hamit Thaçi, aktivist i Mbledhjes së Bunjajt, 1943/44, tani i ndjerë, Adem Demaçi, Shaip Saliu...). U prezantua me kumtesën, “Bashkojmë gjeneratat”.

Simpozium „100 Vjet Kuvendi i Karadakut” Kumanovë /2012 „Kuvendi i Karadakut në mbamendjen e popullit”, ku pos pjesëmarrësve të tjerëve, ishte edhe Rektori i USHT-së i shoqëruar nga prorektorët.

Ka marrë disa mirënjohje dhe dekorata ndër të cilat edhe nga Presidenti i Republikës së Kosovës.

III.1. Artikuj shkencorë

1. Kadri Bazi... /pjesa e parë Studime Albanologjike Nr 2, Shkup / 2010
2. Kadri Bazi... /pjesa e dytë Studime Albanologjike Nr 3 Shkup / 2011
3. Qasje e shkurtër mbi të folmen e Kumanovës Studime Albanologjike në Nr. 5, 2012
4. Qasje e shkurtër mbi të folmen e Kumanovës Studime Albanologjike në Nr. 6, 2012

III.2. Pjesëmarrje dhe publikime në konferencat ndërkombëtare

1. “Marrëveshja Kornizë, në mes të implementimit dhe devijimit”, EKSPD, 2003, Shkup.
2. “Stabiliteti në Republikën e Maqedonisë dhe marrëdhëniet bilaterale me Republikën e Bullgarisë”, në “Forumi Ballkanik-Iniciativa për Paqe dhe Evro-integrime”, Sofje 2005.
3. Kumtesa, “Shqiptarët e Kumanovës Brenda realitetit ndëretnik” 2008, Kumanovë.
4. Kumtesa “Leka i pari” 2010, Kumanovë.
5. Kumtesa “Bashkojmë gjeneratat”, 2011, Kumanovë.
6. Kumtesa „Kuvendi i Karadakut në mbamendjen e popullit”, 2012, Kumanovë.
7. Kumtesa “USHT mes sfidave dhe zhvillimit”. 2014, Durrs.
8. Kumtesa “Paraqitja e risive për Kuvendin e Karadakut”... 2016, Kumanovë.
9. Kumtesa “Krijuesi popullor për krijimin e personalitetit”, 2016, Kumanovë.

10. Seminari Albanologjik me kumtesën nxjerrë nga punimi shkencor “Fjala është e para” (dorëshkrim), Kumtesa “Fjalë me tingujt që s’i shkruajmë”, 2017, Tetovë.

III.4. Libra të botuar

1. “Popullit tim”, faqe 87+ , KSh: „Jehona e Karadakut”, 2002
2. „Krisma e heshtur” Faqe 150+, KSh: „Jehona e Karadakut”, 2005/ Me mjete nga M. Kulturës së RM-së Botuar me ISBN
3. „Këngët e kaçakëve në Malësinë e Karadakut”, /Faqe 200+ KSh: „Jehona e Karadakut”, 2006, Botuar me ISBN Me mjete nga M. Kulturës së RM-së
4. „Drama shqipe në Maqedoni nga fillet e saja deri më sot”, faqe 200+, KSh: „Jehona e Karadakut”, 2009/ - Botuar me ISBN Me mjete nga M. Kulturës së RM-së
5. „Kroni i Kreshtave tona” f:140+, KSh: „Jehona e Karadakut”, 2010/ Botuar me ISBN Me mjete nga M. Kulturës së RM-së
6. „Uji dhe dheu nuk digjen”, f:180+, KSh: „Jehona e Karadakut”, 2011/ Botuar me ISBN Me mjete nga M. Kulturës së RM-së
7. „Rrënjët e Kullës”, f:100+, KSh: „Jehona e Karadakut”, 2011/ - Botuar me ISBN Me mjete nga M. Kulturës së RM-së
8. „Drejt Përjetësisë”, / f:180+ , Studim/ 2013, Botuar me ISBN Me mjete nga M. Kulturës së RM-së
9. „Rrugëtimi drejt luftës për paq” , f: 500+, botues **“Instituti për Studime Politike dhe Ndërkombëtarë”** , -Shkup/ 2014 / Botuar me ISBN
10. „100 Vjet Kuvendi i Karadakut” f: 200+, 2015 / Botuar me, ISBN Me mjete nga M. Kulturës së RM-së

III.8. Veprimtaria nga interesi më i gjerë

1. Është bashkëthemelues dhe anëtarë i klubit të shkrimtarëve “Jehona e Karadakut”, 1992.
2. Është bashkëthemelues i dhe anëtarë në redaksinë e revistës për shkencë dhe kulturë “Doruntina”, 1992.
3. Është bashkëthemelues dhe drejtues i “Takimeve poetike të Karadakut”, 1992.
4. Bashkorganizator i Simpozium shkencor „Rëndësia e mbledhjes së dhe studimit të folklorit dhe etnografisë” (forum Ballkanik), 2016.
5. Bashkorganizator i Simpozium, i organizuar dhe i mbështetur nga Qeveria RM-së dhe Komunës së Kumanovës, me temë “Kumanova për paqe”, 2008”.
6. Është organizator, dhe moderator i Manifestim i 30 vjetorit të demonstratave të vitit 1981 me titull: “Bashkojmë gjeneratat”. Kumanovë, 2011
7. Është organizator i Simpoziumit „100 Vjet Kuvendi i Karadakut” , Kumanovë /2012

PËRFUNDIM DHE PROPOZIM

Të arriturat e deritanishme të dr.ass. Nami Beqiri në nivelin profesional dhe shkencor, përparimi në punën shkencore, realizimi i suksesshëm i ligjëratave nga lëndët në Universitetin e Tetovës, temat e mbrojtura të magjistraturës dhe doktoratës, punimet dhe librat e botuara, **japin garanci** të fuqishme se bëhet fjalë për ligjërues të afirmuar të gjuhës dhe letërsisë shqipe. Kjo njëkohësisht është **edhe garanci** se dr.ass. Nazmi Beqiri do të vazhdojë ta kryejë me sukses veprimtarinë arsimore sipas kritereve të larta që i parashtron ligjërimit dhe mësimi i gjuhës dhe letërsisë shqipe.

Duke pasur parasysh aktivitetin shkencor, profesional dhe mësimor pedagogjik të kandidatit, komisioni Recensues është i mendimit se i plotëson të gjitha kushtet ligjore të parapara me Ligjin për arsimin sipëror dhe ka nder të veçantë që ti propozojë Këshillit Mësimor-Shkencor të Fakultetit Filologjik pranë Universitetit të Tetovës që dr.ass. Nazmi Beqiri me titullin **Docent** në Fakultetin Filologjik pranë Universitetit të Tetovës.

Komisioni recensues :

1. Prof. dr. Ejup Hajdini – profesor i rregullt (kryetar);

2. Prof.dr.Lultjeta Isakur, – profesreshë e rregullt (anëtare)

3. Prof. dr. Salajdin Saliu – profesor doc. Por në procedurë administrative e ka fituar thirrjen shkencore inordinar (anëtar).

V. FORMULARI PËR RAPORTIN PËR ZGJEDHJE NË THIRRJEN MËSIMORE-SHKENCORE

Në shtojcat e mëposhtme është bashkangjitur formulari për raportin e zgjedhjes në thirrjen mësimore-shkencore. Kandidati Nazmi Beqiri ka grumbulluar gjithsej 145 pikë, edhe atë për: veprimtarinë mësimore-arsimore 35 pikë, veprimtarinë shkencore-hulumtuese 76, veprimtarinë profesionale-aplikative 20 pikë dhe veprimtarinë me interes më të gjerë 14 pikë.

REFERENCAT PROFESIONALE TË KANDIDATIT PËR ZGJEDHJEN NË THIRRJE	PIKË
VEPRIMTARIA MËSIMORE-SHKENCORE	35
VEPRIMTARIA SHKENCORE-HULUMTUESE	76
VEPRIMTARIA PROFESIONALE-APLIKATIVE	20
VEPRIMTARIA ME INTERES MË TË GJËRË	14
Gjithsej	145

SH T O J C Ë

PËR RECENSIONIN PËR ZGJEDHJEN NË THIRRJEN MËSIMORE-SHKENCORE, SHKENCORE DHE MËSIMORE-PROFESIONALE

Kandidati: Nazmi Baki Beqiri

Institucioni: Fakulteti Filologji, në
Universiteti i Tetovës, Tetovë

I. VEPRIMTARIA MËSIMORE-ARSIMORE

Nr. rendor	Emri i aktivitetit: Mbajtja e ligjëratave të ciklit të parë për vitet akademike: 2008/2009; 2009/2010; 2010/2011; 2011/2012; 2012/2013; 2013/2014; 2014/2015; 2015/2016; 2016/017; 2017/2018	Pikët
	Semestri dimëror, 2008/2009 FAB Kumanovë	
1	Gjuhë shqipe (2+1) (3x15=45) Kumanovë	1
	Semestri veror, 2008/2009 FAP Kumanovë	
2	Gjuhë shqipe (2+1) (3x15=45x) Kumanovë	1
	Semestri dimëror, 2009/2010 FAB Kumanovë	
3	Gjuhë shqipe (2+1) (3x15=45) Kumanovë	1
	Semestri veror, 2009/2010 FAP Kumanovë	
4	Gjuhë shqipe (2+1) (3x15=45x) Kumanovë	1
	Semestri dimëror, 2010/2011 FAB Kumanovë	
5	Gjuhë shqipe (2+1) (3x15=45x) Kumanovë	1
	Semestri veror, 2010/2011 FAP Kumanovë	
6	Gjuhë shqipe (2+1) (3x15=45x) Kumanovë	1
	Semestri dimëror, 2011/2012 FAB Kumanovë	
7	Gjuhë shqipe (2+1) (3x15=45x) Kumanovë	1
	Semestri veror, 2011/2012 FAP Kumanovë	
8	Gjuhë shqipe (2+1) (3x15=45x) Kumanovë	1
	Semestri dimëror 2012/2013 Gjuhë dhe Letërsi Angleze Kumanovë	
9	Gjuhë shqipe I, (2+1) (3x15=45) Kumanovë	1
	Semestri veror 2012/2013	

10	Gjuhë shqipe II, (2+1) (3x15=45x) Kumanovë	1
	Semestri dimëror 2013-2014 Filologjik, Gj.L.Angleze, Kumanovë	
11	Praktikumi i gjuhës shqipe(2+1) (3x15=45x) Kumanovë	1
12	Historia e Librit, F.Gj.LShqipe, (2+1) (3x15=45x) Tetovë	1
13	Gjuhë shqipe, FSHMN, Matematikë (2+1) (3x15=45x) Tetovë	1
	Semestri veror , 2013-2014	
14	Civilizim shqiptar, F.A,P.dhe Diz. (2+1) (3x15=45x) Tetovë	1
	Semestri dimëror 2014/2015 Filologjik, Gj.L.Angleze, Kumanovë	
15	Gjuhë shqipe I, (2+1) (3x15=45x) Kumanovë	1
16	Gjuhë shqipe Gjuhë shqipe ESR, Tetovë (2+1) (3x15=45x)	1
	Semestri veror 2014/2015 Filologjik, Gj.L.Angleze, Kumanovë	
17	Gjuhë shqipe II, (2+1) (3x15=45x) Kumanovë	1
18	Gjuhë shqipe, FSHMN, Matematikë (2+1) (3x15=45x) Tetovë	1
	Semestri dimëror , 2015/ 2016, ESR, Tetovë	
19	Gjuhë shqipe (2+1) (3x15=45x) Tetovë	1
20	Civilizim shqiptar, Filologjik, Gj.L.Ang, (2+1) (3x15=45x) Kum	1
	Semestri veror , 2015/ 2016, (2+1) (3x15=45x) Tetovë	
21	Civilizim shqiptar, F.A,P.dhe Diz. (2+1) Tetovë	1
	Semestri dimëror , 2016/ 2017	
22	Gjuhë shqipe ESR, (2+1) (3x15=45x) Tetovë Tetovë	1
23	Civilizim shqiptar, Filol, Gj.L.Ang, (2+1) (3x15=45x) Kum	1
24	Gjuhë shqipe 3 F.J.Gaz. (2+1) (3x15=45x) Shkup	1
	Semestri veror , 2016/ 2017	
25	Historia e Librit, F.Gj.LShqipe, (2+1) (3x15=45x) Tetovë	1
26	Gjuhë shqipe, FSHMN, Inf. (2+1) (3x15=45x) Kumanovë	1
27	Civilizim shqiptar, F.Ek. (2+1) (3x15=45x) Shkup	1
28	Gjuhë shqipe 4 F.J.Gaz. (2+1) (3x15=45x) Shkup	1
	Semestri dimëror , 2017/ 2018	
29	Gjuhë shqipe, F.F. GJ.Maq. (2+1) (3x15=45x) Tetovë	1
30	Gjuhë shqipe 3 F.J.Gaz. (2+1) (3x15=45x) Tetovë	1
31	Civilizim shqiptar, F.A. Pik.dhe Diz., (2+1) (3x15=45x) Tetovë	1
	Semestri veror , 2017/ 2018	
32	Historia e Librit, F.Gj.LShqipe, (2+1) (3x15=45x) Tetovë	1
33	Gjuhë shqipe 4 F.J.Gaz. Tet. (2+1) (3x15=45x) Tetovë	1
34	Historia e dramës, F.A.Dramë, (2+1) (3x15=45x) Tetovë	1
35	Historia e dramës, F.A. Regji, (2+1) (3x15=45x) Tetovë	1
	Gjithësej:	35

II. VEPRIMTARIA SHKENCORE-HULUMTUESE

Nr.r	Titulli	
1	“Popullit tim”	6
2	„Krisma e heshtur”	6
3	„Këngët e kaçakëve në Malësinë e Karadakut” (studim monografi)	10
4	„Drama shqipe në Maqedoni nga fillet e saja deri më sot” (studim monografi)	10
5	„Kroni i Kreshtave tona” (studim monografi)	10
6	„Uji dhe dheu nuk digjen”	6
7	„Rrënjët e Kullës”	6
8	„Drejt Përjetësisë”	6
9	„Rrugëtimi drejt luftës për paq”	6
10	„100 Vjet Kuvendi I Karadakut”	10
	Gjithësej:	76

Artikuj me rezultate shkencore origjinale, të publikuara në revistë profesionale/shkencore

Nr.r.	Titujt	
1	“Marrëveshja Kornizë, në mes të implementimit dhe devijimit”	2
2	“Stabiliteti në Republikën e Maqedonisë dhe marrëdhëniet bilaterale me Republikën e Bullgarisë”,	2
3	„Shqiptarët e Kumanovës Brenda realitetit ndëretnik”	2
4	“Leka i pari”	2
5	“Bashkojmë gjeneratat”	2
6	„Kuvendi i Karadakut në mbamendjen e popullit”	2
7	“USHT mes sfidave dhe zhvillimit”	2
8	“Paraqitja e risive për Kuvendin e Karadakut”	2
9	“Krijuesi popullor për krijimin e personalitetit”	2
10	“Fjalë me tingujt që s’i shkruajmë”	2
	Gjithësej:	20

7. VEPRIMTARI ME INTERES MË TË GJËRË

Nr.r	Tituj	
1	Themelues dhe anëtarë i klubit të shkrimtarëve “Jehona e Karadakut”,	2
2	Themelues i dhe anëtarë në redaksinë e revistës për shkencë dhe kulturë “Doruntina”,	2
3	Themelues dhe drejtues i “Takimeve poetike të Karadakut”,	2
4	Është organizator, dhe moderator i Manifestim i 30 vjetorit të demonstratave të vitit 1981	2
5	Është organizator i Simpoziumit „100 Vjet Kuvendi i Karadakut”	2
6	Bashkorganizator i Simpozium, i organizuar dhe i mbështetur nga Qeveria e RM-së dhe Komunës së Kumanovës, me temë “Kumanova për paqe 2008”,	2
7	Bashkorganizator i Simpozium shkencor „Rëndësia e mbledhjes së dhe studimit të folklorit dhe etnografisë” (forum Ballkanik) /2016	2
	Gjithësej:	14

Komisioni recensues :

1. Prof. dr. Ejup Hajdini – profesor i rregullt (kryetar);

2. Prof.dr. Lultjeta Isakur, profesoreshë e rregullt (anëtare)

3. Prof. dr. Salajdin Saliu – profesor doc. Por në procedurë administrative e ka fituar thirrjen shkencore inordinar (anëtar).

Tetove, 2018

Deri te:

KËSHILLI I REKTORATIT TË UNIVERSITETIT TË TETOVËS

RAPORT I KOMISIONIT RECEZENTUES PËR ZGJEDHJE-RIZGJEDHJE TË MËSIMDHËNËSVE NË TË GJITHA THIRRJET MËSIMORESHKENCORE TË UNIVERSITETIT TË TETOVËS

Në bazë të propozimit të Këshillit Mësimor-Shkencor të Fakultetit Filologjik, të Universitetit të Tetovës, të datës 19.06.2018 lidhur me Konkursin, për zgjedhjen/rizgjedhjen e mësimdhënësve në thirrje mësimore-shkencore, të shpallur në të përditshmet “Koha” dhe “Nova Makedonija” të datës 04.06.2018, si dhe në web-faqen e Universitetit www.unite.edu.mk, Këshilli i Rektoratit, në mbledhjen e mbajtur solli vendim për formim të Komisionit recensues, në përbërje:

1. Prof.dr Ejup Ajdini (kryetar) profesor i rregullt në Fakultetin Filologjik të *Universitetit të Tetovës*
2. Prof. dr Majlinda Nuhiu (anëtar) profesor i rregullt në Fakultetin Filologjik të *Universitetit të Tetovës*
3. Doc. dr Hyreme Gura (anëtar) profesor i rregullt në Fakultetin Filologjik të *Universitetit të Tetovës*

Në konkurs për mësimdhënës për lëndët: **Letërsi angleze V dhe VI** është paraqitur një kandidat, edhe atë:

1. Dr.sc. Suzana Ibraimi Memeti, mësimdhënëse në programin studimor Gjuhë dhe letërsi angleze në Fakultetin Filologjik të Universitetit të Tetovës.

Komisioni recensues, pasi e kontrollon materialin e konkursit, titullit të lartpërmendur i paraqet këtë:

REFERAT

I. TË DHËNA BIOGRAFIKE DHE ZHVILLIMI PROFESIONAL

Kandidatja Dr. Sc Suzana Ibraimi Memeti është e lindur më datë 24.08.1984 në Tetovë, Republika e Maqedonisë. Shkollën fillore dhe të mesme i ka mbaruar me sukses në Tetovë. Në korrik të vitit 2007 diplomoi në **Fakultetin e Trajnimit Pedagogjik e Metodologjik-Dega e Gjuhës dhe Letërsisë Angleze të Universitetit të Evropës Juglindore**, dhe mori kualifikimin Profesor i Gjuhës dhe Letërsisë Angleze. Pas diplomimit në vitin akademik 2007/08, është regjistruar në studime pas diplomike, programi studimor Gjuhë dhe letërsi angleze të Universitetit të Evropës Juglindore, ku më datë **08/2010** mbroi me sukses temën e magjistraturës në bazë të kurrikulumit të Fakultetit të Gjuhëve, Kulturës Kulturës dhe Komunikimit duke fituar diplomë profesionale të Edukimit të Lartë dhe titullin profesional *Magjistër në fushën e Mësimdhënies së Gjuhës Angleze* me temë: **“The effectiveness of teaching writing strategies to EFL University students in Tetovo and its importance for developing critical thinking”- “Efektiviteti i mësimi të strategjive të shkruarit tek studentët universitar në Tetovë që mësojnë gjuhën angleze si gjuhë e huaj dhe rëndësia e tyre për zhvillimin e të menduarit kritik**

Në vitin 2011, kandidatja Dr. Suzana Ibraimi Memeti është regjistruar në studime të doktoraturës në Fakultetin e Gjuhëve të Huaja, Departamenti i Gjuhës Angleze, në Universitetin e Tiranës, Shqipëri. Më 9.11.2016 me sukses mbroi disertacionin e doktoraturës me temë: **“TEMAT DHE KARAKTERET FEMËRORE NË ROMANIN VIKTORIAN”** dhe morri graden Doktor i Shkencave në Letërsi nën udhëheqjen e Prof. Dr. Refik Kadija.

Përgjatë studimeve të saja, Dr. Suzana Ibraimi Memeti përkaj edukimit dhe arsimimit formal, është trajnuar edhe përmes trajnimeve të shumta joformale ku përfitoi një numër të madh certifikatash, të cilat i mundësuan të përfitojë aftësi komunikuese, profesionale dhe shkathtësi jetësore.

Nga viti akademik 2007/2008 e deri më sot punon si mësimdhënëse në Fakultetin Filologjik, programi studimor Gjuhë dhe letërsi angleze, pranë USHT-së.

II. VEPRIMTARIA MËSIMORE-ARSIMORE

Gjatë viteve akademike të periudhës 2007-2018 në Fakultetin Filologjik, programi studimor Gjuhë dhe letërsi angleze, Dr. Suzana Ibraimi Memeti ka mbajtur ligjërata dhe ushtrime tek lëndët në ciklin e parë të studimeve si: Gjuhë bashkëkohore angleze I, II, III, IV, Shkrim akademik I, II, Metodologjia e gjuhës angleze, Letërsi angleze III, IV, V,VI, Letërsi Amerikane I, II, si dhe Gjuhë angleze I, II, III dhe IV (jashtë katedrës).

Në përputhje me Rregulloren dhe procedurën për zgjedhjen në thirrjet mësimore shkencore, mësimore-profesionale dhe bashkëpunëtor në Universitetin Shtetëror të Tetovës, kandidatja Dr. Suzana Ibraimi Memeti ka realizuar gjithsej **190.35** pikë nga veprimtaria mësimore-arsimore.

III. VEPRIMTARIA SHKENCORE-HULUMTUESE

Krahas angazhimit në procesin mësimor, kandidatja është marrë vazhdimisht me hulumtime shkencore në fushën e Filologjisë, gjegjësisht të lëmisë së Gjuhës angleze. Veprimtaria shkencore-hulumtuese e kandidatës përbëhet nga artikuj shkencorë të botuar në revista shkencore ndërkombëtare, me pjesëmarrje në tubime shkencore ndërkombëtare dhe pjesëmarrje në projekte ndërkombëtare. Kjo veprimtari e kandidatës është paraqitur më poshtë.

A) Artikuj shkencor:

<p>➤ Mr. Suzana Ibraimi Memeti, “<i>Transfer in Second Language Acquisition</i>” <i>SUT Scientific Observer. Vol.1.Issue 2&3.2011</i>. SUT Scientific Observer. Academic and Scientific Journal of Linguistics, Literature, Education and Culture Published Annually by the Department of English Language and Literature, State University of Tetova, 2011.</p>
<p>➤ Mr. Suzana Ibraimi Memeti, punimin shkencor me titull: “<i>Snobbism and vanity: features of hierarchical Victorian society presented in Victorian novels.</i>” Buletini shkencor Ndërkombëtar numër VIII-të vëllimi i parë në revistën „Buletini shkenor“ ISSN 1800-9794 COBISS, CG-ID 20683538, Shtypshkronja "Dukagjini ", ONLINE, www.ekonomskiinstitut.com. Publikimet, Botime shkencore revista nr.8 vllimi 1.</p>
<p>➤ Mr. Suzana Ibraimi Memeti, “<i>Tema e Respektabilitetit në Romanet e Periudhës Viktoriane dhe në Jetën Reale Bashkëkohore në Maqedoni</i>” p.240-246. 821 (4) “18”(049/3). Vol.3/No.4/Tetove, 4.2015Filologjia. International Journal of Human Sciences. UDC: 81/UDC:82 ISSN 1857-8535 (Print).</p>
<p>➤ Mr. Suzana Ibraimi Memeti, “<i>The process of writing in educational settings (EFL students of English language)</i>” p. 88-92. ANGLISTICUM, A Multi-disciplinary Research Journal. Volume 5 Number 2, February 2016. p -ISSN 1857-8179 e- 1857-8187 IC Impact Factor: 6.88.</p>

B) Pjesmarja në konferenca

<p>➤ Mr. Suzana Ibraimi Memeti, “Teaching Writing Strategies in an EFL Environment: a Study Conducted in Macedonia.” ASSE- First ASSE International Conference on British and American Studies, University of Vlora “Ismail Qemali”, Albania on 11-13 June 2011.</p>
<p>Mr. Suzana Ibraimi Memeti, “Learner Autonomy in Writing Classes.” International Conference at South East European University of Tetovo, Macedonia, in co-operation with University of Teacher Education in Zug, Switzerland, on 29-30 November 2013.</p>
<p>➤ Mr. Suzana Ibraimi Memeti, “Features of Female Characters in the Victorian Novel.” International Conference of English and American Studies: Shaping the Way we Promote English. University of Shkodra “Luigj Gurakuqi”, on 14 November 2014.</p>
<p>➤ Mr. Suzana Ibraimi Memeti, “Respectability in Victorian Novels and in the Real Contemporary Life of Macedonia.” Second International Scientific Conference of the Philological Faculty (ISCP2015), State University of Tetova, Macedonia, on 24-25 April 2015.</p>
<p>➤ Mr. Suzana Ibraimi Memeti, “Treatment of Contemporary Social Issues in Victorian Era Literature.” 5th International Conference on Foreign Language FLTAL Teaching and Applied Linguistics and International Forum on Slavic Studies. 7-9 May, 2015. International Burch University, Sarajevo, Bosnia and Herzegovina.</p>
<p>➤ Mr. Suzana Ibraimi Memeti, “Snobbism and vanity: features of hierarchical Victorian society presented in Victorian novels.” Instituti për kërkime shkencore dhe zhvillim-Ulqin, Mali I Zi, 1 Prill 2016. Konferenca e VIII-të: Roli dhe efektiviteti I investimeve në procesin e integritit të shoqërive ballkanike pas Marrëveshjes së Stabilizim Asocimit. E-ISBN 2337-0521 ISSN 1800-97 94.</p>

Kandidatja në fjalë bashkë me fletë aplikimin ka dorëzuar edhe: Vërtetim për përvojë pune në Universitetin e Tetovës; Diplomën e Studimeve deridiplomike; Diplomën e Magjistraturës; Diplomën e Doktoraturës, Certifikatën e notave për studimet deridiplomike; CV akademike; Listën e punimeve shkencore të botuara së bashku me kopje të ballinave të revistave dhe faqeve të punimeve; Kopje të çertifikatave nga pjesëmarrja në Konferenca Ndërkombëtare; Kopje origjinale të punimit të Doktoraturës; çertifikatë e Nënshetësisë dhe çertifikatë lindjeje.

PËRFUNDIMI DHE PROPOZIMI

Në bazë të pasqyrës të prezantuar më lartë si dhe nga të dhënat në **Shtojcë**, komisioni Recensues i vlerëson pozitivisht aktivitetet në veprimtaritë mësimore-arsimore, shkencore-hulumtuese, profesionale-aplikative dhe veprimtarinë me interes më të gjerë dhe konstaton se kandidatja Dr. Sc. Suzana Ibraimi Memeti në përputhje me Rregulloren për kriteret dhe procedurën për zgjedhje në thirrjet mësimore-shkencore, shkencore, mësimore-profesionale dhe të bashkëpunorit në Universitetin e Tetovës (Buletini i Universitetit), ka tubuar gjithsej **244.35 pikë** nga referencat profesionale dhe me këtë e ka kaluar numrin minimal të pikëve që duhet të realizohen për zgjedhjen në thirrjen mësimore-shkencore **docent**.

Duke u bazuar në të dhënat e mësipërme për aktivitetin e përgjithshëm të kandidatit, Komisioni përfundon se Dr.sc. Suzana Ibraimi Memeti ka kualitet shkencor dhe profesional dhe sipas Ligjit për arsim të lartë si dhe në përputhje me Rregulloren për kriteret dhe procedurën për zgjedhje në thirrjet mësimore-shkencore, shkencore, mësimore-profesionale dhe të bashkëpunorit në Universitetin e Tetovës i plotëson të gjitha kushtet që të zgjidhet në thirrjen që ka konkurruar.

Komisioni Recensues ka nderin dhe kënaqësinë t'i propozojë Këshillit të Rektoratit të Universitetit të Tetovës që kandidatja Dr.sc. Suzana Ibraimi Memeti të zgjidhet në thirrjen mësimore-shkencore **DOCENT** për lëndën: **Letërsi angleze V dhe VI**, programi studimor Gjuhë dhe letërsi angleze (Fakulteti Filologjik).

ANËTARËT E KOMISIONIT RECENSUES:

1. **Prof. Dr. Ejup Ajdini, (kryetar)**

2. **Prof. Dr. Majlinda Nuhiu, (anëtar)**

3. **Doc. Dr. Hyreme Gura, (anëtar)**

S H T O J C Ë

PËR RECENSIONIN PËR ZGJEDHJEN NË THIRRJEN MËSIMORE-SHKENCORE, SHKENCORE DHE MËSIMORE-PROFESIONALE

Kandidati: Suzana Ibraimi Memeti

Institucioni: Fakulteti Filologjik-UT, Tetovë

Lëmia shkencore: Letërsi

I. VEPRIMTARIA MËSIMORE-ARSIMORE

Nr. rendor	Emri i aktivitetit:	Pikët
I.1	Mbajtja e ligjëratave (lëndët në ciklin e parë të studimeve)	117.6
	Letërsi angleze V, (Fakulteti Filologjik-Gj. angleze) 1 semestër, 2+2	$2 \times 15 \times 1 \times 0.04 = 1.2$
	Letërsi angleze VI, (Fakulteti Filologjik-Gj. angleze) 1 semestër, 2+2	$2 \times 15 \times 1 \times 0.04 = 1.2$
	Gjuhë angleze I, (Fakulteti i Arteve, art figurativ) 9 semestra 2+2	$2 \times 15 \times 9 \times 0.04 = 10.8$
	Gjuhë angleze II, (Fakulteti i Arteve, art figurativ) 9 semestra 2+2	$2 \times 15 \times 9 \times 0.04 = 10.8$
	Gjuhë angleze III (Fakulteti i Arteve, art figurativ) 9 semestra 2+2	$2 \times 15 \times 9 \times 0.04 = 10.8$
	Gjuhë angleze IV, (Fakulteti i Arteve, art figurativ) 9 semestra 2+2	$2 \times 15 \times 9 \times 0.04 = 10.8$
	Gjuhë angleze I, (Fakulteti i Arteve, art muzikor) 6 semestra 2+1	$2 \times 15 \times 6 \times 0.04 = 7.2$
	Gjuhë angleze II, (Fakulteti i Arteve, art muzikor) 6 semestra 2+2	$2 \times 15 \times 6 \times 0.04 = 7.2$
	Gjuhë angleze III, (Fakulteti i Arteve, art muzikor) 6 semestra 2+2	$2 \times 15 \times 6 \times 0.04 = 7.2$
	Gjuhë angleze IV, (Fakulteti i Arteve, art muzikor) 6 semestra 2+2	$2 \times 15 \times 6 \times 0.04 = 7.2$
	Gjuhë angleze I, (Fakulteti i Arteve, art dramatik) 4 semestra 2+2	$2 \times 15 \times 4 \times 0.04 = 4.8$
	Gjuhë angleze II, (Fakulteti i Arteve, art dramatik) 4 semestra 2+2	$2 \times 15 \times 4 \times 0.04 = 4.8$
	Gjuhë angleze I, (Fakulteti i Shkencave të Zbatuara, mekatronike) 1 semestër 2+2	$2 \times 15 \times 1 \times 0.04 = 1.2$
	Gjuhë angleze II, (Fakulteti i Shkencave të Zbatuara, mekatronike) 1 semestër 2+2	$2 \times 15 \times 1 \times 0.04 = 1.2$
